



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMI I CILËSISË
SEKTORI I KURRIKULAVE

Nr. 2271/ Prot
12

Tiranë, më 25.10.2022

UDHËZIM

Mbi fazën e katërt të regjistrimeve për vitin akademik 2022-2023

Në vijim të procesit të aplikimeve të pranimeve të reja në programet e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” dhe në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë në Drejtësi, për vitin akademik 2022-2023, bazuar në Udhëzimin e MAS nr. 10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL-të”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit të Përbashkët të QSHA dhe RASH nr. 8, datë 30.06.2022, “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në IAL, për vitin akademik 2022-2023”:

UDHËZOJ:

1. Pas përfundimit të tre fazave të Raundit të tretë, njësitë kryesore të bëjnë publike kuotat e lira të pranimit për secilin program studimi, në datën **02 nëntor 2022** dhe të ndjekin më pas procedurat përkatëse sipas këtyre afateve:
 - Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e tretë dhe nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, kanë të drejtë të bëjnë kërkesë në datën **03 nëntor 2022, ora 09:00-16:00**.
 - Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë në ato programe studimi që kanë aplikuar në raundin e tretë.
 - Njësitë kryesore për çdo program studimi publikojnë listat e kandidatëve fitues në mjediset e fakultetit dhe në faqet web përkatëse në datën **04 nëntor 2022**.
 - Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet në sekretarinë mësimore në datat **05-06 nëntor 2022, ora 09:00-16:00**.
2. Pas përfundimit të Raundit të tretë, njësitë kryesore të bëjnë publike kuotat e lira të pranimit për secilin program studimi, në datën **06 nëntor 2022** dhe të ndjekin më pas procedurat përkatëse sipas këtyre afateve:
 - Kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania dhe rezultojnë të paregjistruar në një program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi, ku ka kuota të paplotësuara, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme në datën **7 nëntor 2022, ora 09:00-14:00**.

- Kandidatët fitues përzgjidhen sipas kriterëve të pranimit për secilin program studimi.
 - Njësitë kryesore për çdo program studimi publikojnë listat e kandidatëve fitues në mjediset e fakultetit dhe në faqet web përkatëse në datën **7 nëntor 2022, ora 18:00**.
 - Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet në sekretarinë mësimore në datën **8 nëntor 2022, ora 09:00-16:00**.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, të gjithë Fakultetet dhe Filiali i UT-së, Sarandë.
4. Ky Udhëzim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, të Fakulteteve dhe të Filialit të UT-së, Sarandë.

